



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1066/Prot
4

Tiranë, më 4.11.2016

VENDIM

Nr. 71, datë 4.11.2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, Ligjit Nr.44/2015, datë 30.04.2015, "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit Hotel "*Capital*" sh.p.k. Tiranë, me aktivitetin e tij në formën ligjore person juridik,

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhërit Nr. 212, datë 05.10.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për kryerjen e hetimit administrativ, më datë 10.10.2016 e në vazhdim, grupi i inspektimit filloi procesin e hetimit administrativ pranë kontrolluesit, Hotel "*Capital*" sh.p.k. Tiranë, me objekt:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit Hotel "*Capital*" sh.p.k. Tiranë.

Gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, në datë 10.10.2016, grupi i kontrollit u shmang nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhërin Nr. 212, datë 05.10.2016 të Komisionerit "*Për kryerjen e hetimit administrativ*", që do të ushtrohej pranë këtij kontrolluesi.

Grupit të inspektimit ju kërkua të largohet menjëherë nga ambientet e kontrolluesit, duke pretenduar se në ambientet e hotelit po kryheshin punime. Pretendimi i administratorit se po kryheshin punime nuk qëndronte, pasi grupi i kontrollit konstatoi se në hotel kishte klientë të cilëve u ofrohej shërbimi i hotelerisë. Gjithashtu, në regjistrat e QKR-së (QKB), subjekti rezulton të jetë aktiv. Ky mosbashkëpunim, u pasua me sjellje të ashpra dhe reagime fyese ndaj grupit të kontrollit.

Në funksion të asaj ç'ka grupi i inspektimit mundi të konstatojë në lidhje me aktivitetin e kontrolluesit Hotel "Capital" sh.p.k. Tiranë, rezulton si më poshtë:

1. Kontrolluesi Hotel "Capital" sh.p.k. Tiranë, informon subjektet e të dhënave personale me tabela informuese.
2. Kontrolluesi Hotel "Capital" sh.p.k. Tiranë, sipas verifikimeve nga regjistrat kontrolluesve të Zyrës së Komisionerit, rezulton të ketë përmbushur detyrimin për njoftim.

Sa më sipër, grupi i inspektimit e pati të pamundur ekzekutimin në vend të objektit sipas Urdhërit Nr.212, datë 05.10.2016 të Komisionerit dhe parimeve bazë në Kodin e Procedurave Administrative të R.SH.

Faktet e mësipërme përbëjnë shkelje administrative, të nenit 32 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Në cilësinë e provës materiale, këtij procesverbali i bashkëngjiten këto dokumente:

- Fotografi të ambienteve;
- Ekstrakt i QKR-së (QKB);
- Formular Njoftimi.

Në këto kushte, grupi i kontrollit hartoi procesverbalin, pranë institucionit të Zyrës së Komisionerit, në pamundësi fizike për ta hartuar atë në prani të përfaqësuesve të kontrolluesit Hotel "Capital" sh.p.k., Tiranë.

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", datë 30.04.2015, përpara marrjes së aktit final, kontrolluesi Hotel "Capital" sh.p.k. Tiranë, është njoftuar zyrtarisht mbi procesverbalin dhe pjesëmarrjen në seancë dëgjimore që do zhvillohej në datë 25.10.2016, për të ushtruar të drejtën e tij për tu dëgjuar. Përfaqësuesja e kontrolluesit u paraqit në seancë dëgjimore, dhe u shpreh:

"Nuk kemi patur dijeni rreth Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", dhe kjo është arsyeja e sjelljes të administratorit në datë 11.10.2016".

Ky pretendim nuk qëndron, edhe sikur të jetë i vërtetë fakti i padijenisë së ligjit, pasi kontrolluesi Hotel "Capital" sh.p.k. Tiranë, ka përmbushur detyrimin për njoftim në vitin 2013.

Zyra e Komisionerit, sjell në vëmendje të kontrolluesit Hotel "Capital" sh.p.k. Tiranë, nenin 32 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, i cili shprehet:

"1. Institucionet publike dhe private bashkëpunojnë me komisionerin, duke i siguruar të gjithë informacionin që ai kërkon për përmbushjen e detyrave, si dhe e njoftojnë atë për zbatimin e rekomandimeve të dhëna menjëherë pas mbarimit të afatit të caktuar për kryerjen e tyre.

2. Komisioneri ka akses në sistemin e kompjuterëve, në sistemet e arkivimit, që kryejnë përpunimin dhe transferimin e tyre, për ushtrimin e të drejtave dhe të detyrave që i janë ngarkuar me ligj."

Moszbatimi i nenit 32 Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, penalizohet sipas nenit 39, pika 1, gërma *dh/1*, i cili shprehet:

"..kontrolluesit dhe përpunuesit që veprojnë në kundërshtim me pikën 2 të nenit 32 të këtij ligji, dënohen me 100 000 deri në 1 000 000 lekë".

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit konkludon se shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39 pika 1, gërma "*dh/1*" të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, janë serioze dhe si të tilla, këto shkelje përbëjnë "*kundërvajtje administrative*", të cilat sanksionohen me gjobë.

Kontrolluesi Hotel "*Capital*" sh.p.k. Tiranë, në formën ligjore të aktivitetit të tij është person juridik dhe, sipas nenit 39/2 për kundërvajtjet e mësipërme, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara konsistojnë në shmangie nga detyrimet ligjore dhe mosbashkëpunim me institucionin shtetëror.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të nenit 39 pika 1, gërma "*dh/1*" si dhe nenit 39, pika 2 e Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit Hotel "*Capital*" sh.p.k. Tiranë, me gjobë në vlerën **400 000 (katërqind mijë) lekë**, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 32 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
2. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot, më 4.11.2016

